

SHOQËRIA E BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR
“ DROPULL - POGON “

AKTI I THEMELIMIT

Në Jorgucat, sot në datën 31/05/2023, nismëtarët e mëposhtëm, personat fizik dhe juridik:

1. Bashkia Dropull me NIPT K43522603V.
2. Koço Qiqi i biri i Panajotit i datelindjes 12/01/1979 me NID : H90112166O.
3. Kostaq Kazaqi i biri i Gligorit me i datelindjes 06/08/1987 me NID : I70806031G.
4. Odhisea Niko i biri i Theodhorit i datelindjes 19/07/1982 me NID : I20719028U.
5. Andon Gjika i biri i Vangjelit i datelindjes 17/09/1965 me NID : G50917012I.
6. Jorgo Lloli i biri i Koços i datelindjes 22/08/1951 me NID : F10822010J.
7. Vasili Dhima i biri i Janit i datelindjes 17/12/1998 me NID : J81217021R.
8. Dhimitraq Gjika i biri i Janit i datelindjes 31/07/1968 me NID : G80731015H
9. Klinton Beqari i biri i Kadriut i datelindjes 09/01/1994 me NID : J40109021O.

I. Themelimi

Vendosin themelimin e shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor “ DROPULL - POGON ” (“Shoqëria”), bazuar në ligjin nr. 38/2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”. Themeluesit kanë vendosur të organizohen vullnetarisht me qëllim përmbushjen e nevojave dhe interesave të tyre në fushën e agro-përpunimit dhe bujqësisë në përgjithësi në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë, si dhe me çdo vendim të organeve të shoqërisë. Shoqëria do të ushtrojë veprimtari për një periudhë të pacaktuar.

II. Deklarata e anëtarësisë

Anëtarët themelues, me anë të nënshkrimit të aktit të themelimit, deklarojnë se përmbushin kriteret për të qenë anëtarë të shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor “ DROPULL - POGON ” dhe pranojnë që të zbatojnë aktin e themelimit, statutin dhe vendimet e organeve drejtuese të shoqërisë si dhe të zbatojnë standardet më të larta kombëtare dhe ndërkombëtare në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga anëtarësia në shoqëri. Anëtarët, gjithashtu deklarojnë

që në dijeninë e tyre nuk ekziston asnjë shkak që kufizon anëtarësinë e tyre në shoqëri.

III. Selia

Selia e shoqërisë është në adresën: Ne Zonen Kadastrale me Nr.3480, me Numer Pasurie 24 me emertimin “ ANDHRIANUPOLEOS “ ne fshatin Sofratike, Njesia Dropulli i Poshtem, Bashkia Dropull.

IV. Objekti

3.1. Shoqëria ka për objekt kryerjen e veprimtarive si më poshtë:

A. merr, trajton, ruan, magazinon, prodhon, përpunon, tregton, blen, shet ose merret me çdo mënyrë a mjet tjetër me produkte bujqësore, për anëtarët e saj ose edhe për personat fizik ose juridik, jo anëtarë, në masën e lejuar nga ligji.

B. kryen çdo veprim tjetër që lidhet me prodhimin, përpunimin dhe tregtimin në fushën e produkteve bujqësore në tërësi, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

3.2. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, Shoqëria ka të drejtë:

- (i) të mundësojë trajnime profesionale për anëtarët e saj apo palët e treta;
- (ii) të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar dhe industrial, dhënie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore që mund të konsiderohen si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë;
- (iii) të kryejë çdo aktivitet në lidhje me publikimin, marketingun apo reklamimin;
- (iv) të zotërojë kuota/aksione apo çdo lloj interesi tjetër në shoqëri të tjera, pavarësisht fushës në të cilën kryejnë veprimtari këto shoqëri.
- (v) të kryejë çdo veprim tjetër në përmbushje të interesave dhe nevojave të anëtarëve të saj sipas dispozitave të statutit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

3.3. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e favorizon atë.

3.4. Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse. Ajo zbaton standartet më të larta të etikës.

3.5. Shoqëria kryen veprimtari dhe shërbime në kuadër të objektit të përcaktuar më sipër, përveç se me anëtarët e saj edhe me persona fizik ose juridik, të tretë, jo anëtarë, deri në 40 përqind të totalit të të ardhurave nga veprimtaritë e saj, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 38/2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”.

V. Statuti

Anëtarët Themelues kanë rënë dakort për miratimin e statutit të shoqërisë sipas tekstit bashkëlidhur këtij akti themelimi të nënshkruar rregullisht nga ortakët.

VI. Kapitali i regjistruar

Vlera e Kapitalit të regjistruar të shoqërisë është **150.000 (Njëqind e pesëdhjetë mijë leke) Lek.** Kapitali ndahet në **9 kuota, nga te cilat 1 kuote e zotëruar nga Bashkia Dropull me 51% te kapiatit dhe 8 kuota te tjera të barabarta,** me vlere 9187.5 (Nente mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtate pike pese) lek secila, të renditura nga numri 1 deri në numrin 9, të nënshkruara nga anëtarët themelues si më poshtë vijon:

<i>Anëtari</i>	<i>Kuota</i>	<i>Numërtimi</i>	<i>Përqindja e zotëruar në kapitalin</i>	<i>Vlera nominale</i>
Bashkia Dropull	1	1	51 %	76.500
Koço Qiqi	1	2	6.125%	9.187,5
Kostaq Kazaqi	1	3	6.125%	9.187,5
Odhisea Niko	1	4	6.125%	9.187,5
Andon Gjika	1	5	6.125%	9.187,5
Jorgo Lloli	1	6	6.125%	9.187,5
Vasili Dhima	1	7	6.125%	9.187,5

Dhimitraq Gjika	1	8	6.125%	9.187,5
Klinton Beqari	1	9	6.125%	9.187,5

VII. Administratori

Shoqëria do të administrohet nga një Administrator, të Drejtat dhe Detyrimet e të cilit janë të parashikuara në Ligjin për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor, në Statutin e Shoqërisë si dhe në Aktin e Emerimit të tij.

Administrator i Shoqërisë është:

Zoti Jorgo Lloli, lindur në Gjirokaster, Shqipëri me datë 22/08/1951 mbajtës i kartes se identitetit me nr. 033502665, me numër personal F10822010J, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.









Kohëzgjatja e funksionit të Administratorit është për një periudhë prej 5 vjetësh, duke filluar që nga data e themelimit, me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori vepron individualisht dhe si firmëtar i vetëm në lidhje me çdo çështje të Shoqërisë e cila i është caktuar shprehimisht ose në rast se nuk i është përcaktuar shprehimisht, çdo çështje që përfshihet në administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë.

Me datën 31/05/2023, në Jorgucat, u hartua dhe u nënshkrua, me vullnetin e lire të anëtarëve themelues, ky Akt Themelimi i Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor

“ **DROPULL - POGON**”, në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njejtë ligjore.

ANËTARËT THEMELUES

1. KOSO QIQI 
2. Dhimitraq Gjura 
3. Vasiloc Phum 
4. Adhisea Nika 
5. Kostur Vajapete 
6. Jorgio Lohi 
7. Andon Gjura 
8. Klontan Bexsari 
9. Plimitraq Jole 